



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË  
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Nr. 2224 / Prot.  
1

Tiranë, më 16.6.2022

**NJOFTIM PËR VENDE PUNE**

**A. Lëvizja paralele**

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, Kreu V – “Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”, nenit 25 “Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës, dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, Kreu VII dhe planit vjetor të pranimit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, njofton se:

**a) Në Administratën e tij ka 1 (një) vend të lirë pune të kategorisë ekzekutive, në grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm, në pozicionin:**

- Specialist në Sektorin e Administrimit Financë –Buxhet (Specialist Buxheti).

Punonjësi duhet të ofrojë një shërbim sipas standardeve të cilësisë dhe të kohës.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori, për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

**b) Përshkrimi i detajuar i vendit të punës:**

Specialisti në Sektorin e Administrimit Financë – Buxhet, në ILDKPKI, ka përgjegjësi për ndjekjen e zbatimit të limitit mujor të buxhetit të planifikuar të ILDKPKI; ndjek dhe zbaton regjistrin e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla; mban përgjegjësi për zbatimin e ligjshmërisë për prokurimin publik me vlera të vogla, duke realizuar blerjet me vlera të vogla në bashkëpunim me anëtarët e njësisë së prokurimit dhe komisionin e blerjeve të vogla; ndjek në dinamikë planet e zbatimit të shpenzimeve buxhetore për automjetet në përdorim të ILDKPKI; kontrollon normativat e harxhimit të materialeve dhe shërbimeve sipas urdhrave përkatëse; ndjek në dinamikë shërbimet e brendshme të mirëmbajtjes së institucionit dhe mban shpenzimet analitike buxhetore të shërbimit telefonik fiks, celular, dhe të automjeteve; kryen rakordimin mujor dhe 4/mujor të



shpenzimeve me degën e Thesarit Tiranë dhe hartimin e situacionit mujor dhe progresiv; përpilon Urdhërpagesat për të gjitha transaksionet financiare të ILDKPKI dhe kalimin e tyre në Thesar dhe Bankë si dhe kryen ndjekjen gjatë gjithë vitit të transaksioneve financiare –buxhetore.

**c) Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:**

- të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon,
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi,
- të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”,
- të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

**Kriteret e veçanta për këtë vend pune janë:**

- arsim të lartë në shkencat ekonomike, sipas legjislacionit të arsimit të lartë,
- të ketë njohuri në fushën e financave publike,
- të ketë aftësi të mira komunikuese,
- të ketë njohuri në një gjuhë të huaj,
- të ketë njohuri të programeve bazë kompjuterike dhe në programet informatike financiare,
- të ketë aftësi të punës në grup,
- nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike.

**Paga e pozicionit- III-b**

Në përputhje me Vendimin nr. 48, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.55/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, të ndryshuar”.

**ç) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Sektorin e Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurive, këto dokumenta:**

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant,
- Jetëshkrimi i plotësuar,
- Fotokopje e diplomës.(Përfshirë dhe diplomën Bachelor). Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet t’ a ketë të njësuar atë pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin,
- Fotokopje e listës së notave,
- Fotokopje e librezës së punës,
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore,
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore,
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt,
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi,
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit,
- Fotokopje e kartës së identitetit.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.



d) Pranimi i dokumentave do të bëhet deri në datën 28.6.2022.

dh) Në datën 30.6.2022, do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të ILDKPKI dhe në ambientet e brendshme të ILDKPKI). Këta do të jenë ata kandidatë që plotësojnë kushtet minimale të lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, të kërkuara më sipër.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e ILDKPKI, nëpërmjet adresës së e-mail.

Kandidatët që rezultojnë të pakualifikuar, paraqesin ankesat me shkrim në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimimit.

e) Konkurrimi- intervista me gojë do të bëhet në datën 12.7.2022, në ambientet e ILDKPKI, në orën 10:00.

ë) **Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurrimi:**

Kandidatët do të testohen për njohuritë e tyre në lidhje me:

- Kushtetutën,
- Ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9367 datë 7.4.2005, “Për pandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,
- Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

f) Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Brendshëm, i ngritur pranë ILDKPKI. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- 40 pikë për dokumentacionin dhe
- 60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

Dokumentacioni i dorëzuar i ndarë në:

- 20 pikë për përvojën,
- 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet në fushën përkatëse dhe
- 10 pikë për vlerësimin pozitiv të rezultateve individuale.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me;

- Njohuritë, aftësitë dhe kompetencën, në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës,
- Eksperiencën e tyre të mëparshme,
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**g) Lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve) do të shpallet në datën 13.7.2022.**

**gj) Njoftimi** do të bëhet në portalin "*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*", në faqen zyrtare të ILDKPKI dhe në ambientet e brendshme të ILDKPKI.

Këta do të jenë ata kandidatë që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të kërkuara më sipër. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 3 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimimit.

Për sqarime, mund të kontaktoni në adresën: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Rruga "Reshit Çollaku", Tiranë. Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

Nëse nuk ka fitues nga procedura e lëvizjes paralele, konkurrimi do të vazhdojë sipas Kreut IV – "*Pranimi në shërbimin civil*", të Ligjit nr.152/2013, datë 30.5.2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 243, datë 18.3.2015 "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës, dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*", i ndryshuar.

## **Kreu II, "Pranimi në shërbimin civil".**

### **B. Pranimi në shërbimin civil**

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, procedura do të vazhdojë me plotësimin e vendeve të lira pune, të kategorisë ekzekutive në grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm në pozicionin Specialist, në Sektorin e Administrimit të Financë –Buxhet (Specialist Buxheti).

Këtë Informacion do ta merrni në faqen zyrtare të ILDKPKI, në portalin "*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*" dhe në ambientet e brendshme të ILDKPKI. Edhe për këtë procedurë aplikohet në të njëjtën kohë.

### **a) Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurrimi.**

Kandidatët do të testohen për njohuritë e tyre në lidhje me:

- Kushtetutën,
- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*", i ndryshuar;

- Ligjin nr. 9367 datë 7.4.2005, "Për pandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;
- Ligji nr. 60/2016, datë 2.6.2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar;
- Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
- Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,
- Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar,
- Ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

### **Konkurrimi.**

Konkurimi do të mbështetet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe do të kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë.

Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza;

- Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta.
- Vlerësimi i kandidatëve.

### **b) Kërkesat e Përgjithshme.**

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar:

- të jetë shtetas shqiptar,
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur,
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse,
- të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje,
- ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

### **c) Pëshkrimi i detajuar i vendit të punës;**

Specialisti i Buxhetit përgjigjet për ndjekjen e zbatimit të limitit mujor të buxhetit të planifikuar të ILDKPKI; ndjek dhe zbaton regjistrin e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla; mban përgjegjësi për zbatimin e ligjshmërisë për prokurimin publik me vlera të vogla, duke realizuar blerjet me vlera të vogla në bashkëpunim me anëtarët e njësisë së prokurimit dhe komisionin e blerjeve të vogla; ndjek në dinamikë planet e zbatimit të shpenzimeve buxhetore për automjetet në përdorim të ILDKPKI; kontrollon normativat e harxhimit të materialeve dhe shërbimeve sipas urdhrave përkatëse; ndjek në dinamikë shërbimet e brendshme të mirëmbajtjes së institucionit dhe mban shpenzimet analitike buxhetore të shërbimit telefonik fiks, celular, dhe të automjeteve; kryen rakordimin mujor dhe 4/mujor të shpenzimeve me degën e Thesarit Tiranë dhe

hartimin e situacionit mujor dhe progresiv; përpilon Urdhërpagesat për të gjitha transaksionet financiare të ILDKPKI dhe kalimin e tyre në Thesar dhe Bankë si dhe kryen ndjekjen gjatë gjithë vitit të transaksioneve financiare –buxhetore.

**ç) Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon;**

- arsim të lartë në shkencat ekonomike, sipas legjislacionit të arsimit të lartë,
- të ketë njohuri në fushën e financave publike,
- të ketë aftësi të mira komunikuese,
- të ketë njohuri në një gjuhë të huaj,
- të ketë njohuri të programeve bazë kompjuterike dhe në programet informatike financiare,
- të ketë aftësi të punës në grup,
- nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike.

**d) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Sektorin e Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurive, këto dokumenta:**

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant,
- Jetëshkrimi i plotësuar,
- Fotokopje e diplomës. (*Përfshirë dhe diplomën Bachelor*). Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet t'a ketë të njëzuar atë pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin,
- Fotokopje e listës së notave,
- Fotokopje e librezës së punës,
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore,
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore,
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt,
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi,
- Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit,
- Fotokopje e kartës së identitetit.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

**dh) Pranimi i dokumentave do të bëhet deri në datën 4.7.2022.**

**e) Lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin, do të shpallet në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të ILDKPKI dhe në ambientet e brendshme të ILDKPKI më datë 11.7.2022.**

Këta do të jenë ata kandidatë që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të kërkuara më sipër.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse e ILDKPKI, nëpërmjet adresës e-mail. Kandidatët që nuk janë kualifikuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Njësine Përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit.



**ë) Konkurrimi - testimi me shkrim dhe intervista me gojë, do të zhvillohet më datë 25.7.2022, në orën 10:00, në ambientet e ILDKPKI.**

**f) Mënyra e vlerësimit.**

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë institucionit të ILDKPKI. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- vlerësimi i jetëshkrimit - 15 pikë,
- intervista e strukturuar me gojë - 25 pikë,
- testimi me shkrim - 60 pikë.

Pas përfundimit të vlerësimit të testimit me shkrim, kur kandidati merr më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë), nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të jetëshkrimit. Nëse kandidati grumbullon mbi 45 (dyzet e pesë) pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë.

**g) Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë dhe kompetencën, në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**Lista e fituesve do të jetë me kandidatë që kanë fituar me mbi 70 pikë (mbi 70% të pikëve).**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, ILDKPKI do të njoftojë ata individualisht, në mënyrë elektronike, për rezultatet (*nëpërmjet adresës e-mail*).

Njoftimi i fituesit do të bëhet në portalin "*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*", në faqen zyrtare të ILDKPKI dhe në ambientet e brendshme të ILDKPKI.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për këtë procedurë, duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ILDKPKI.

Për sqarime, mund të kontaktoni në adresën: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Rruga "Reshit Çollaku", Tiranë.

**ILDKPKI  
NJËSIA PËRGJEGJËSE**